




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar: Prijmljeno/Prodato Received/Delivered	04.02.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	560/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1215/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1215/2021 të datës 23.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1215/2021 e datës 23.12.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.20/2021 i datës 10.12.2021, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 23.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6304/21, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.20/2021 të datës 10.12.2021, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar SKPK), ndërsa më datë 10.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 27/22 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.12.2021 me numër protokolli 6304/2021, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2021; Përgjigje në ankesë e datës 10.01.2022; Akt Emërim i datës 12.02.2013; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Shpallje e Brendshme (Avancim në Karrierë) e datës 07.10.2021; Vendim me numër KA.Nr.20/2021 i datës 10.12.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesë e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 16.11.2021; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuara; Lista përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë i datës 21.10.2021; Njoftim i datës 21.10.2021; Aplikacioni për punësim i [] i datës 13.10.2021; Rekomandim i datës 11.10.2021; Rekomandim i datës 11.10.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.12.2019; Bashkangjitur shkresa shkathtësitë profesionale dhe menaxherial; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.12.2020; Bashkangjitur shkresa shkathtësitë profesionale dhe menaxheriale, Vërtetim me nr.158/2021 i datës 12.10.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.12.2018; Certifikatë e datës 20.07.2020; Diplomë me nr. 236/20 i datës 16.09.2020; Certifikatë e datës 07.10.2021; Aplikacioni për punësim i [] i datës 12.10.2021; Diplomë me nr.51/12 i datës 23.07.2012; Vërtetim me nr. 166/2021 i datës 12.10.2021; Akt Emërim i datës 14.12.2013; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.12.2020; Bashkangjitur shkresa shkathtësitë profesionale dhe menaxheriale; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.12.2019; Bashkangjitur shkresa shkathtësitë profesionale dhe menaxheriale; Certifikatë e datës 11.10.2021; Shkresat për listën e ngushtë të poentimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores; Formulari i vlerësimit individual në intervistë me gojë i datës 02.11.2021; Formulari i vlerësimit individual në intervistë me gojë i datës 02.11.2021; Formulari i vlerësimit individual në intervistë me gojë; Formulari i vlerësimit individual në intervistë me gojë i datës 02.11.2021; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare i datës 08.11.2021; Pliko me nr. 13/2022 i datës 10.01.2022, Vendim me nr. DPSKPK/333/2021 i datës 19.10.2021; Lista e shkurtër e datës 21.10.2021; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare i datës 08.11.2021; Regjistri i njoftimit për ardhjen në interviste; E-mail nga [] për [] i datës 01.02.2022; E-mail nga [] për [] i datës 01.02.2022; E-mail nga [] për [] i datës 02.02.2022; E-mail nga [] për [] i datës 02.02.2022; E-mail nga [] për [] etj. i datës 21.10.2021; Lista e shkurtër e datës 21.10.2021; Shpallje e Brendshme (Avancim në Karrierë) e datës 07.10.2021; Deklaratë për mosekzistim të konfliktit të Interesit e [] i datës 29.10.2021; Testi me shkrim i [] i datës 29.10.2021; Deklaratë për mosekzistim të konfliktit të Interesit e [] e datës 29.10.2021; Testi me shkrim i [] i datës 29.10.2021; Deklaratë për mosekzistim të konfliktit të Interesit e [] i datës 29.10.2021; Testi me shkrim i [] i datës 29.10.2021; Aplikacioni për punësim i [] i datës 14.10.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i [] i datës 28.05.2021; Akt Emërimi i [] i datës 21.06.2012; Shënime të inkuadrimit në punë i [] e datës 31.12.2014; Kontratë e Marrëdhënies së Punës së [] e datës 01.12.2014; Vërtetim me nr. DBNJ/Nr.171/2021 i datës 14.10.2021; Certifikatë me nr.ref.3634/1215 e datës 04.12.2015; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.12.2019; Shkathtësitë dhe aftësitë profesionale Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.12.2020; Shkathtësitë dhe aftësitë profesionale; Formulari për

vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.12.2018; Shkathtësitë dhe aftësitë profesionale; Aplikacioni për punësim i Zyle Syla i datës 12.10.2021; Diplomë me nr. 939/15 i datës 29.07.2015; Certifikatë e datës 05.11.2018; Certifikatë e datës 21.09.2009; Certifikatë e datës 14.12.2007; Akt Emërim i datës 12.02.2013; Vërtetim me nr. DBNJ/Nr.150/2021 i datës 08.10.2021; Referencë për Zyle Syl ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 11.12.2019; Shkathtësitë dhe aftësitë profesionale; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 17.12.2020; Shkathtësitë dhe aftësitë profesionale dhe Certifikatë e datës 07.10.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 07.10.2021 ka shpallur konkursin e brendshëm avancim në karrierë Nr.Ref. KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-013, për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores" në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 07.10.2021 deri me datë 14 tetor 2021, ndërsa interesim konkurrimi kanë shprehur gjithsej tetë(8) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin Në listën e ngushtë të datës 21.10.2021, e publikuar në webfaqen e sistemit prokurorial, janë përfshirë vetëm tre (3) kandidatë: dhe . Kurse bazuar në Njoftimin për përzgjedhje të përfundimtare të datës 08.11.2021 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të SKPK-së, kandidati është shpallur si kandidati me i suksesshëm me gjithsej 70.4 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me Njoftimin përfundimtar, me datë 16.11.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.20/2021 të datës 10.12.2021, refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 16.11.2021, me arsyetimin së ankuesi nuk ka përvojë profesionale pas diplomimit e mbi të cilën bazë ka vepruar edhe Komisioni Përzgjedhës.

Ankuesi kundër Vendimit KA.Nr.20/2021 të datës 10.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK, brenda afatit ligjor, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vlerësimin të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës. Thekson se, vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë me shkelje të dispozitave të nenit 9 të Rregullores Nr.02/20210 për Avancimin në Karrierë të Shërbyesve Civilë, duke shtuar tutje se i njëjti ka plotësuar të gjitha kriteret sipas konkursit, ndërsa kandidati i përzgjedhur ka të përfunduar bechelor (tre vjeçar) i cili nuk konsiderohet program i kompletuar universitar sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe se nuk ka katër vite përvojë pune profesionale. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procedurën e rekrutimit për pozitën e Udhëheqësit të Shkrimores në Prokurorinë e Apelit, sipas Konkursit nr.ref.KPK/SKPK ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Aktgjykimin me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka gjetur së Gjykata Kushtetuese në pikën III të aktgjykimit ka konstatuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk*

zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë. Andaj, në kuptim të këtij aktgjykimi Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në raport me Këshillin Prokurorial zbatohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit me rastin e shpalljes se konkursit për pozitën e Udhëheqësit Sektorit të Shkrimores në Prokurorinë e Apelit në Prishtinë, ka përcaktuar si kritere themelore: *Diplomë e Fakultetit Juridik ose Administratë Publike; dhe minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale.*

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë me shkelje të nenit 9 të Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Kolegji ju referua nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimit të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale"* si dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 9 me të cilin përcaktohet se: *"1. Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil janë: 1.1. kalimi i kohës minimale në gradën e tyre ekzistuese në bazë të rregullave të përcaktuara më këtë Rregullore; 1.2. plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse; 1.3. kalimi me sukses të testimit me shkrim dhe me gojë; 1.4. rezultatet e vlerësimit në punë të jenë: mirë, shumë mirë ose shkëlqyeshëm; 1.5. të mos jetë në procedurë disiplinore; 1.6. të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në 3 vitet e fundit; 1.7. të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale"* Ndërsa lidhur me kohën për avancim, me nenin 10 po të njëjtës Rregullore është paraparë se: *"...Koha minimale për avancim nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë ose nga një kategori funksionale më e ulët në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm"*... Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se kandidati i për zgjedhur ka plotësuar kërkesat për avancim gjegjësisht i njëjti ka kaluar kohën minimale për avancim pasi që sipas Akt Emërimit me nr.protokolli ZBNJ/DP-161/2013 të datës 14.02.2013 është emëruar në pozitën e Arkivistit-pozitë e karrierës e të cilën pozitë e ka ushtruar deri në për zgjedhjen e tij në pozitën në fjalë, ka plotësuar kualifikimet e kërkuar profesionale ashtu siç është përcaktuar me Konkursin e datës 07.10.2021, ka kaluar testin me shkrim dhe gojë duke u vlerësuar nga Komisioni Përzgjedhës si kandidati me i suksesshëm, sipas formularëve për vlerësim të performances së punës për vitin 2019 dhe 2020 është vlerësuar nga mbikëqyrësi i tij me notë të përgjithshme 4 "shumë mirë", dhe se në shkresat e lëndës nuk gjinden dëshmi për ndonjë masë disiplinore të shqiptuar ndaj tij apo se ndaj të njëjtit është iniciuar ndonjë procedurë penale, kështu që, bazuar në këtë konstatim Kolegji vlerëson se është i pa bazuar pretendimi ankimor i ankuesit se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë me shkelje të nenit 9 të Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Tutje, Kolegji lidhur me pretendimin ankimor se ankuesi ka plotësuar të gjitha kushtet sipas konkursit, Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të të njëjtit, respektivisht sipas Diplomës me Nr.236/20 të datës 16.09.2020, të lëshuar nga Kolegji "Biznesi", konstatoi se ankuesi



me datë 20.07.2020, ka përfunduar studimet në programin LLB në Juridik me specializim në Penalo Juridik, e si rrjedhojë Kolegji vlerëson se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale katër (4) vjeçare siç kërkohet me konkurs, sepse përvojë profesionale njihet vetëm përvoja e fituar pas diplomimit në ndonjërin nga fushat respektive të përcaktuara me konkurs (Juridik ose Administratë Publik). Ndërlidhur me këtë konstatim, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin ARJ-UZVP Nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës përmes të cilit është konfirmuar njohja e përvojës profesionale vetëm pas diplomimit.

Lidhur me pretendimin ankimor së kandidati i përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e konkursit pasi që i njëjti ka diplomë beachelor vetëm me tri vite studime, dhe se nuk ka përvojën profesionale 4 vjeçare, Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur sipas Diplomës me Nr.51/12 të datës 23.07.2012, të lëshuar nga Universiteti Dardania, me datë 21.07.2012 ka përfunduar studimet themelore universitare në Fakultetin Juridik-Departamenti i Kriminalistikës, ndërsa lidhur me kriterin e përvojës së punës konkretisht sipas Akt emërimit me nr.protokolli ZBNJ/DP-161/2013 të datës 14.12.2013 dhe Vërtetimin DBNJ/Nr.166/2021 të datës 12.10.202, kandidati i përzgjedhur deri në datën e mbylljes së konkursit (14.10.2021), ka përvojë pune pas diplomimi mbi 8 vite, kështu që bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit si me lart, pasi që sipas Konkursit me Nr.Ref. KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-013, si kriter themelor është kërkuar diplomë nga fusha e Juridikut ose Administratës Publike, pa paspecifikuar se kandidati duhet të ketë të përfunduar fakultetin tre apo katër vjeçar të studimeve ose të ketë numër përkatës të kredive-ECTS, e mbi këtë bazë, rrjedhë se kandidati i përzgjedhur ka përmbushur kërkesat e arsimit dhe përvojës së punës profesionale ashtu siç është kërkuar me konkursin në fjalë.

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas listës përmbledhëse të vlerësimeve të Komisionit Përzgjedhës i themeluar me Vendimin DSPKPK/333/2021 të datës 17.10.2021 të U.d Drejtorit të Përgjithshme të SKPK-së, kandidati është vlerësuar si kandidati me më shumë pikë me gjithsej 70.4 pikë, andaj, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me të cilin është përcaktuar se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se procedura e konkurrimit për Udhëheqës të Sektorit të Shkrimores në Prokurorinë e Apelit, është zhvilluar në pajtim me nenin 11 Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.20/2021 të datës 10.12.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.*

Kështu që, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, /Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1215/2021

Çlirim Zeka



Procesmbajtës



Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.